

20191241756

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT
PËR PUNËSIM DHE SIGURIM NË RAST TË PAPUNËSISË

Neni 1

Në Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 37/97, 25/00, 101/00, 50/01, 25/03, 37/04, 4/05, 50/06, 29/07, 102/08, 161/08, 50/10, 88/10, 51/11, 11/12, 80/12, 114/12, 39/14, 44/14, 113/14, 56/15, 129/15, 147/15, 154/15, 27/16, 119/16, 21/18 dhe 113/18), në tërë tekstin pas fjalës “Republika e Maqedonisë” shohet fjala “së Veriut”, përveç në nenin 98-gj paragrafin 1 alinenë 3.

Neni 2

Në nenin 3-a paragrafi (4) shlyhet.

Neni 3

Në nenin 17 në alinenë 1 pas fjalëve: “profesione deficitare”, shtohen fjalët: “si dhe persona të rinj deri në 29 vjet”.

Neni 4

Në nenin 19 në paragrafin 1 pas alinesë 17 shtohet aline e re 18, si vijon:

“-dhënie të shërbimeve edhe personave të rinj deri në 29 vjeç, të cilët për herë të parë paraqiten në Agjenci si persona të papunësuar;” .

Neni 5

Në nenin 53 pas paragrafit 4 shtohet paragrafi i ri 5, si vijon:

“Me përjashtim të paragrafit 4 alinesë 3 të këtij neni, si person i papunësuar, në kuptim të këtij ligji, konsiderohet personi i cili është pronar, themelues ose udhëheqës i shoqërisë tregtare dhe person tjetër juridik ose është anëtar i organit udhëheqës, përkatësisht person i autorizuar në shoqëri tregtare dhe person juridik tjetër, përveç në shoqata dhe fondacione, ndërsa i cili është shfrytëzues i ndihmës së garantuar minimale, në pajtim me dispozitat e fushës së ndihmës sociale”.

Paragrafi (5) bëhet paragrafi (6).

Neni 6

Në nenin 56 paragrafët 4, 5 dhe 6 shlyhen.

Neni 7

Në nenin 57 paragrafi 1 alineja 2 ndryshohet si vijon:

“- në vendin e punës që është në largësi më së shumti 50 kilometra prej adresës ku jeton personi deri në vendin e punës, përkatësisht më së shumti 30 kilometra për person të papunësuar që jeton i pavarur me fëmijë në moshë më të vogël se 15 vite, në kuadër të familjes së përbashkët dhe”.

Neni 8

Në nenin 58 alineja 2 ndryshohet si vijon:

“- në vendin e punës që është në largësi më së shumti 50 kilometra prej adresës ku jeton personi deri në vendin e punës, përkatësisht më së shumti 30 kilometra për person të papunësuar që jeton në i pavarur me fëmijë në moshë më të vogël se 15 vite, në kuadër të familjes së përbashkët dhe”.

Neni 9

Në nenin 59 pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri 2, si vijon:

“Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, personi i papunësuar i cili është shfrytëzues i ndihmës së garantuar minimale në pajtim me dispozitat nga fusha e mbrojtjes sociale që kërkon punë personalisht ose nëpërmjet sistemit elektronik të Agjencisë, paraqitet në Agjenci në rajonin e së cilës ka vendbanim, të përcaktuar me aktvendim nga qendra për punë sociale”.

Paragrafët 2, 3 dhe 4 bëhen paragrafët 3, 4 dhe 5.

Neni 10

Në nenin 59-a paragrafët 3, 4, 5 dhe 6, shlyhen.

Neni 11

Pas nenit 59-b shtohet nen i ri 59-v, si vijon:

“Neni 59-v

Personi shlyhet prej evidences së personave të papunësuar, nëse:

- tanimë nuk është i papunësuar, sipas dispozitave të këtij ligji,
- vet çlajmërohet prej evidencës së personave të papunë,
- nuk paraqitet në afatin e përcaktuar ligjor ose nuk përgjigjet në ftesën e Agjencisë për shkaqe të paarsyetuara,
- nuk e njofton Agjencin për marrjen dhe humbjen e të drejtave në bazë të sigurimit në rast të papunësisë,
- dy herë gjatë dy viteve refuzon të përfshihet në trajnim, rikualifikim, kualifikim plotësues ose punësim të subvencionuar,
- nuk i plotëson obligimet nga marrëveshja për pjesëmarrje në program për politikë aktive për punësim,
- dy herë gjatë dy viteve refuzon punësim adekuat ose të përshtatshëm ose refuzon të marrë pjesë ose nuk lajmërohet në intervistë për punë në të cilën është dërguar nga Agjencia,
- nuk siguron të dhëna të sakta për nevojat e mbajtjes së evidencës së personave të papunësuar ose për status të pjesëmarrësit në program për politikë aktive për punësim,
- te personi konstatohet ekzistim i shkakut për të cilin përkohësisht nuk mund të punësohet,
- është në paraburgim në kohëzgjatje prej më shumë se gjashtë muajsh ose nëse fillon të vuajë dënim me burg prej gjashtë muajsh e më tepër,
- nga ana e organi inspektues gjendet duke punuar, në kundërshtim me ligjin,
- nuk kërkon punë në mënyrë aktive,
- refuzon të nënshkruajë plan individual për punësim në pajtim me këtë ligj,
- nuk i respekton obligimet e ndërmarra në planin individual për punësim,
- i i plotëson kushte për pension,
- shtetasit të huaj i skadon vlefshmëria e lejes personale për punë,
- refuzon angazhim pune për kryerje të punëve publike dy herë gjatë dy viteve,
- shkon për kryerje të shërbimit vullnetar ushtarak,
- është i vetëpunësuar,
- është pronar, themelues ose udhëheqës i shoqërisë tregtare dhe personi tjetër juridik ose është anëtar i organit udhëheqës, përkatësisht person i autorizuar në shoqëri tregtare dhe person juridik tjetër, përveç në shoqata dhe fondacione,
- kryen veprimtari bujqësore, blegtorie ose tjetër,
- kryen veprimtari zejtare përkatësisht profesionale,
- është shfrytëzues i pensionit,
- ka status të nxënësit në shkollë të mesme, student i rregullt, stazhier dhe person i cili merr pjesë në arsim për të rritur, ndërkaq është më i ri se 26 vjeç dhe

- është i angazhuar me punë ose kryen veprimtari, në kundërshtim me ligjin.

Pjesëmarrja në program për politikë aktive për punësim nuk është arsye për shlyerje nga evidenca e personave të papunësuar, përveç në rastet kur personi merr pjesë në program për politikë aktive për punësim që çon në nënshkrimin e marrëveshjes për punësim, me nënshkrim të marrëveshjes për punësim.

Organi inspektues është i obliguar që me shkrim ta njoftojë qendrën për punë sociale dhe Agjencinë për personin e papunësuar i cili do të gjendet duke punuar në kundërshtim me ligjin.

Personi i cili është shlyer prej evidencës së personave të papunësuar për shkak të bazave nga paragrafi 1 alinetë 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 11, 12, 13, 14 dhe 17 të këtij neni, mund të regjistrohet në evidencën sërish, pas skadimit të një viti nga dita e shlyerjes nga evidenca.”.

Neni 12

Në nenin 61-a paragrafi 2 në pikën 1) alineja 7 ndryshohet si vijon:

“- periudhë në të cilën realizohet e drejta e ndihmës së garantuar minimale, në pajtim me dispozitat nga sfera e mbrojtjes sociale”.

Neni 13

Në nenin 61-b paragrafi 1 ndryshohet si vijon:

“Agjencia grumbullon të dhëna të nevojshme për realizimin e kompetencave të saj, të përcaktuara me ligj, drejtëpërdrejt prej personit me të cilin kanë të bëjnë të dhënat dhe nga evidencat që mbahen në organet në vijim: Drejtoria e të Ardhurave Publike, Fondi për Sigurim Shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Republikës së Maqedonisë, qendrat për punë sociale, Inspektorati Shtetëror i Punës, Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe prej organeve dhe institucioneve tjera të cilat mbajnë evidence, të përcaktuara ose që mbahen në bazë të ligjit, e të cilat janë të nevojshme për realizimin e kompetencave të Agjencisë.”.

Neni 14

Neni 61-gj ndryshohet si vijon:

“Personi shlyhet prej regjistrit të personave të papunësuar ose prej regjistrit të personave të cilët marrin pjesë në programe për politikë aktive për punësim, nëse:

- tanimë nuk është i papunësuar, sipas dispozitave të këtij ligji,
- vet çlajmërohet prej evidencës së personave të papunë,
- nuk paraqitet në afatin e përcaktuar ligjor ose nuk përgjigjet në ftesën e Agjencisë për shkaqe të paarsyetuara,
- nuk e njofton Agjencinë për marrjen dhe humbjen e të drejtave në bazë të sigurimit në rast të papunësisë,
- dy herë gjatë dy viteve refuzon të përfshihet në trajnim, rikualifikim, kualifikim plotësues ose punësim të subvencionuar,
- nuk i plotëson obligimet nga marrëveshja për pjesëmarrje në program për politikë aktive për punësim,
- dy herë gjatë dy viteve refuzon punësim adekuat ose të përshtatshëm ose refuzon të marrë pjesë ose nuk lajmërohet në intervistë për punë në të cilën është dërguar nga ana e Agjencisë,
- nuk siguron të dhëna të sakta për nevojat e mbajtjes së evidencës së personave të papunësuar ose për status të pjesëmarrësit në program për politikë aktive për punësim,
- te personi konstatohet ekzistim i shkakut për të cilin përkohësisht nuk mund të punësohet,
- është në paraburgim në kohëzgjatje prej më shumë se gjashtë muajsh ose nëse fillon të vuajë dënim me burg prej gjashtë muajsh e më tepër,
- nga ana e organi inspektues gjendet duke punuar, në kundërshtim me ligjin,
- nuk kërkon punë në mënyrë aktive,

- refuzon të nënshkruajë plan individual për punësim në pajtim me këtë ligj,
- i plotëson kushte për pension,
- shtetasit të huaj i skadon vlefshmëria e lejes personale për punë,
- refuzon angazhim pune për kryerje të punëve publike dy herë gjatë dy viteve,
- shkon për kryerje të shërbimit vullnetar ushtarak,
- është i vetëpunësuar,
- është pronar, themelues ose udhëheqës i shoqërisë tregtare dhe person tjetër juridik ose është anëtar i organit udhëheqës, përkatësisht person i autorizuar në shoqëri tregtare dhe person tjetër juridik, përveç në shoqata dhe fondacione,
- kryen veprimtari bujqësore, blegtorie ose tjetër,
- kryen veprimtari zeytare përkatësisht profesionale,
- është shfrytëzues i pensionit,
- ka status të nxënësit në shkollë të mesme, student i rregullt, stazhier dhe person i cili merr pjesë në arsimin e të rriturve, ndërkaq është më i ri se 26 vjeç dhe
- është i angazhuar me punë ose kryen veprimtari, në kundërshtim me ligjin.

Neni 15

Në nenin 87-a pas paragrafit 2 shtohet paragraf i ri 3, si vijon:

“Të punësuarit në Agjenci të cilët kryejnë shërbimet të veprimtarisë së punës, përkatësisht të cilët japin shërbime për ndihmë dhe përkrahje të pjesëmarrësve në tregun e punës kanë status të dhënësve të shërbimeve nga veprimtaria e punës (në tekstin e mëtejshëm: dhënës të shërbimeve publike) dhe për ata zbatohen dispozitat e këtij ligji, dispozitat e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik dhe dispozitat e përgjithshme nga fusha e marrëdhënieve të punës.”.

Paragrafët 3 dhe 4 bëhen paragrafë 4 dhe 5.

Neni 16

Neni 87-b ndryshohet si vijon:

“Të punësuarit në Agjenci, në pajtim me llojin e detyrave të punës të cilat i kryejnë mund të jenë të sistemuar në vende pune të: nëpunësve administrativë, dhënësve të shërbimeve publike ose personave ndihmës-teknikë.”.

Neni 17

Neni 87-v ndryshohet si vijon:

“Të punësuarit në Agjenci të cilët kryejnë punë të natyrës administrative për zbatim të punësimit dhe sigurim në rast të papunësisë kanë status të nëpunësve administrative.

Për të punësuarit nga paragrafi 1 i këtij neni, kategoritë, nivelet dhe titujt përcaktohen në pajtim me Ligjin për nëpunës administrativë.

Për çështje që kanë të bëjnë me punësimin, të drejtat dhe detyrat, avancimin, përsosjen dhe aftësimin profesional, matjen e efektit, sistemin e pagave, përgjegjësinë, ndërprerjen e punësimit, mbrojtjen dhe vendimarrjen për të drejtat dhe obligimet dhe çështje tjera në lidhje me marrëdhëniet e punës të nëpunësve administrativë në Agjenci, zbatohen dispozitat e Ligjit për nëpunës administrativë dhe Ligjit për të punësuarit në sektorin publik.”.

Neni 18

Pas nenit 87-v shtohen tetë nëntituj dhe njëzetetë nene të reja 87-g, 87-d, 87-gj, 87-e, 87-zh, 87-z, 87-x, 87-i, 87-j, 87-k, 87-ll, 87-l, 87-m, 87-n, 87-nj, 87-o, 87-p, 87-r, 87-s, 87-t, 87-q, 87-u dhe 87-f, si vijojnë:

“Dhënës të shërbimeve publike

Neni 87-g

Të punësuarit në Agjenci të cilët janë dhënës të shërbimeve publike grupohen në grupin III, nëngrupin 3 nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik.

Për të punësuarit nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohen këto kategori dhe nivele të vendeve të punës:

a) Kategoria A nëpunës profesionistë për përgatitje për punësim (psikologji, pedagogji ose punë sociale dhe politikë sociale)

- Niveli A1 koordinator i seksionit,
- Niveli A2 nëpunës i lartë profesional për përgatitje për punësim,
- Niveli A3 nëpunës i pavarur profesional për përgatitje për punësim,
- Niveli A4 nëpunës profesional për përgatitje për punësim dhe
- Niveli A5 (180/240 SETK) - nëpunës i ri profesionist për përgatitje për punësim.

b) Kategoria B nëpunës profesionalë për ndërmjetësim gjatë punësimit (shkenca organizative dhe udhëheqje (menaxhment), shkenca ekonomike ose shkenca juridike);

- Niveli B1 koordinator i seksionit,
- Niveli B2 nëpunës i lartë profesional për ndërmjetësim gjatë punësimit,
- Niveli B3 nëpunës i pavarur profesional për ndërmjetësim gjatë punësimit,
- Niveli B4 nëpunës profesional për ndërmjetësim gjatë punësimit,
- Niveli B5 (180/240 SETK) nëpunës i ri profesional për ndërmjetësim gjatë punësimit.

I punësuarit nga paragrafi 2 i këtij neni duhet t'i plotësojë kushtet e përgjithshme në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- të jetë i moshës madhore,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

I punësuarit nga paragrafi 2 i këtij neni duhet t'i plotësojë kushtet e veçanta në vijim:

- për nivelin A1 dhe B1 të ketë fituar 240 kredi sipas SETK ose shkallën VII/1 të mbaruar dhe së paku pesë vite përvojë pune në fushën e punës,
- për nivelin A2 dhe B2 të ketë fituar 240 kredi sipas SETK ose shkallën VII/1 të mbaruar dhe së paku tre vite përvojë pune në fushën e punës,
- për nivelin A3 dhe B3 të ketë fituar 240 kredi sipas SETK ose shkallën VII/1 të mbaruar dhe së paku dy vite përvojë pune në fushën e punës,
- për nivelin A4 dhe B4 të ketë fituar 180 kredi sipas SETK ose shkallën VII/1 të mbaruar dhe së paku një vit përvojë pune në fushën e punës dhe
- për nivelin A5 dhe B5 të ketë fituar 180 kredi sipas SETK ose shkallën VII/1 të mbaruar pa ose me përvojë pune.

Për të gjitha nivelet prej kategorisë A dhe B, kushte të veçanta për vendin e punës janë edhe njohja aktive e programeve kompjuterike për punë në zyrë, kompetenca tjera të veçanta të të punës të përcaktuara në aktin për sistematizim të vendeve të punës për vendin përkatës të punës, si dhe njohja aktive të një prej tri gjuhëve më së shpeshti të përdorura në Bashkimin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht).

Krahas kushteve të përgjithshme për plotësimin e vendit të punës të dhënësve të shërbimeve publike, kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta në pajtim me klasifikimin e vendeve të punës.

Klasifikimi i vendeve të punës sipas titullit në kuadër të nivelit të njëjtë nga paragrafi 2 i këtij neni dhe kushtet e veçanta për çdo vend pune, do të përcaktohet me aktin për organizim të brendshëm dhe aktin për sistematizim të vendeve të punës në Agjenci.

Për çështjet që kanë të bëjnë me klasifikimin, punësimin, të drejtat dhe detyrat, avancimin, përsosjen dhe aftësimin profesional, matjen e efektit, sistemin e pagave, përgjegjësinë, ndërprerjen e punësimit, mbrojtjen dhe vendimmarrjen për të drejtat dhe obligimet dhe çështje tjera në lidhje me marrëdhëniet e punës të dhënësve të shërbimeve publike, në Agjenci zbatohen dispozitat e Ligjit për nëpunës administrativë dhe dispozitat e përgjithshme nga fusha e marrëdhënieve të punës.”.

Punësimi dhe avancimi i dhënësve të shërbimeve publike

Neni 87-d

Drejtori i Agjencisë, përgatit plan vjetor për punësim në Agjenci për vitin e ardhshëm, në pajtim me Ligjin për të punësuarit në sektorin publik.

Neni 87-gj

Drejtori i Agjencisë merr vendim për nevojën për punësim të dhënësve të shërbimeve publike, për plotësim të ndonjë vendi të lirë të punës në Agjenci.

Me vendimin nga paragrafi 1 i këtij neni, përcaktohet nëse plotësimi i vendit të lire të punës në Agjenci bëhet nëpërmjet punësimit të personit i cili nëpërmjet shpalljes së konkursit publik, shpalljes së konkursit intern ose mobilitetit nëpërmjet sistemimit ose marrjes, në pajtim me dispozitat e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik.

Me përjashtim të paragrafit 2 të këtij neni, në Agjenci mund të plotësohet vend i punës nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjes për punësim në kohë të caktuar në pajtim me Ligjin për të punësuarit në sektorin publik.

Neni 87-e

Në rast kur nevoja për dhënës të shërbimeve publike sigurohet me shpallje të konkursit publik, i njëjti duhet të publikohet së paku në dy gazeta ditore, nga të cilat së paku në një prej gazetave që shtypen në gjuhën maqedonase dhe në gazetatat që shtypen në gjuhë që e flasin së paku 20% të qytetarëve, të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme prej gjuhës maqedonase. Për çështjet në lidhje me publikimin e konkursit publik zbatohen dispozitat e përgjithshme për marrëdhënie të punës.

Kur punësimi i dhënësve të shërbimeve publike bëhet nëpërmjet konkursit publik, i njëjti duhet t’i përmbajë kushtet që kërkohen për kryerjen e punës, fillimin dhe mbarimin e orarit ditor dhe javor të punës, orarin e kohës së punës dhe shumën me para të pagës themelore për vendin e punës për të cilin kërkohet dhënësi i shërbimeve publike dhe afatin për paraqitje, që nuk mund të jetë më i shkurtër se tri ditë pune.

Drejtori i Agjencisë formon Komision për Seleksionim për Punësim, që është i formuar nga kryetari dhe dy anëtarë nga radha e të punësuarve dhe zëvendës të tyre, me titull të njëjtë ose më të lartë me dhënësin e shërbimeve publike për të cilin vend pune është publikuar konkursi publik, ndërsa njëri anëtar i komisionit është person i punësuar në njësinë organizative për menaxhim me resurse njerëzore.

Procedura për konkursin publik zbatohet në dy faza: seleksionim administrativ, që përbëhet prej kontrollimit të të dhënave të shënuara në fletëparaqitjen dhe dëshmitë e parashtruara në fletëparaqitje dhe intervistë. Për kandidatët për të cilët gjatë seleksionimit administrativ do të konstatohet se nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara në konkursin publik, procedura e seleksionimit përfundon. Për kandidatët tjerë në afat prej pesë ditësh pas përfundimit të seleksionimit administrativ, Komisioni realizon intervistë.

Pas përfundimit të seleksionimit administrativ dhe intervistës, Komisioni për seleksionim për punësim përpilon rang-listë të cilën në afat prej pesë ditësh ia parashtron drejtorit dhe drejtorit ia propozon kandidatin e parë të ranguar drejtorit. Gjatë përpilimit të rang-listës Komisioni për seleksionim për punësim i zbaton dispozitat nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik, për punësimet e kandidatëve me përkatësi të bashkësisë, në pajtim me planin vjetor të Agjencisë.

Drejtori merr vendim për të zgjedhur ose jo ndonjë kandidat, në afat prej tetë ditësh pas pranimit të rang-listës nga Komisioni për Seleksionim për Punësim, që publikohet në internet faqen e Agjencisë. Kundër vendimit, kandidatët e pakënaqur mund të parashtrojnë ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë, në afat prej tetë ditësh nga dita e publikimit në internet faqen e Agjencisë. Pas përfundimit të vendimit për zgjedhje të kandidatit, drejtori nënshkruan marrëveshje për punësim me kandidatin e zgjedhur.

Neni 87-zh

Në rastet kur plotësimi i vendit të lirë të punës bëhet nëpërmjet shpalljes së konkursit intern, i njëjti shpallet në tabelën e shpalljeve të Agjencisë. Gjatë procedurës për avancim respektohet parimi për përfaqësim të drejtë. Procedura për avancim mund të fillojë pasi të merret njoftimi për mjete të siguruara financiare.

Konkursi intern përmban të dhëna për vendin e punës që duhet të plotësohet dhe për kushtet e nevojshme që duhet t'i plotësojë dhënësi i shërbimeve publike, në pajtim me këtë ligj dhe aktin për organizim dhe sistematizim të brendshëm të vendeve të punës në Agjenci dhe afatin për paraqitje në konkursin intern, që nuk mund të jetë më i shkurtër se pesë ditë pune nga dita e publikimit të tij. Në konkursin intern mund të paraqitet dhënësi i shërbimeve publike i punësuar në Agjenci, që i plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara për nivelin përkatës në këtë ligj dhe në aktin e sistematizimit, si dhe:

- të jetë i vlerësuar me notë “4” ose “5” gjatë vlerësimit të fundit,
- të ketë kaluar së paku dy vjet në vendin aktual të punës dhe
- të mos i jetë shqiptuar masë disiplinore në vitin e fundit para publikimit të konkursit intern.

Kandidatët paraqiten në konkursin intern me parashtrim të fletëparaqitjes së plotësuar dhe dëshmi për të dhënat e përfshira në fletëparaqitje dhe të njëjtën nëpërmjet arkivit e parashtrojnë në njësinë organizative për menaxhim me resurse njerëzore. Afati i parashtrimit nuk mund të jetë më i shkurtër se pesë, përkatësisht më i gjatë se dhjetë ditë, nga dita e publikimit të tij.

Drejtori formon Komision për Seleksionim për Avancim, të formuar prej tre anëtarëve nga të cilët njëri është dhënësi i shërbimeve publike me titull të njëjtë ose më të lartë se dhënësi i shërbimeve publike për të cilin vend pune është publikuar konkursi intern, një i punësuar në njësinë organizative për menaxhim me resurse njerëzore dhe udhëheqësi i njësisë organizative në të cilën plotësohet vendi i punës.

Procedura për konkursin intern zbatohet në dy faza: seleksionimi administrativ, që përbëhet prej kontrollimit të të dhënave të shënuara në fletëparaqitje dhe dhe intervista. Për kandidatët për të cilët gjatë seleksionimit administrativ do të konstatohet se nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara në konkursin publik, procedura e seleksionimit përfundon. Për kandidatët tjerë në afat prej pesë ditësh pune pas përfundimit të seleksionimi administrativ, Komisioni realizon intervistë.

Pas përfundimit të seleksionimit administrativ dhe intervistës, komisioni përpilon rang-listë dhe drejtorit ia propozon kandidatin e parë të ranguar. Në afat prej tri ditësh pune nga pranimi i propozimit, drejtori është i obliguar të marrë vendim për zgjedhje. Vendimi për zgjedhje publikohet në internet faqen e Agjencisë.

Drejtori mund të marrë vendim për të mos bërë zgjedhje dhe në të njëjtin është i obliguar t'i paraqesë shkaqet për atë vendim.

Kundër vendimit për zgjedhje ose moszgjedhje, kandidatët e pakënaqur mund të parashtrojnë ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë, në afat prej tetë ditësh nga dita e publikimit në faqen e internetit.

Menaxhim me efektin dhe vlerësimi i dhënësve të shërbimeve publike

Neni 87-z

Të punësuarit në Agjenci të cilët janë dhënës të shërbimeve publike, kanë të drejtë për përsosje profesionale, për çfarë drejtori miraton plan vjetor për trajnime.

Neni 87-x

Agjencia vendos sistem për menaxhim me efektin e dhënësve të shërbimeve publike.

Sistemin nga paragrafi 1 i këtij neni e përbëjnë: përcaktimi i qëllimeve dhe detyrave të punës, përcaktimi i planit individual për përsosje profesionale, si dhe procedurën për vlerësim të efektit të dhënësit të shërbimeve publike.

Qëllimet dhe detyrat e punës përcaktohen nga ana e eprorit të drejtpërdrejtë, në bashkëpunim me dhënësin e shërbimeve publike në dhjetor gjatë vitit rrjedhës për vitin e ardhshëm.

Në planin individual për përsosje profesionale përcaktohet nevoja për përsosje profesionale e dhënësit të shërbimeve publike, për shkak të kryerjes efikase të qëllimeve dhe detyrave të përcaktuara të punës dhe nevojës për zhvillim si dhe avancim të kompetencave të punës.

Plani individual për përsosje profesionale përcaktohet nga ana e eprorit të drejtpërdrejtë në bashkëpunim me dhënësin e shërbimeve publike.

Eprori i drejtpërdrejtë është i obliguar që në kontinuitet ta përcjellë efektin e dhënësit të shërbimeve publike gjatë tërë vitit dhe sipas nevojës të propozojë masa për përmirësimin e të njëjtit.

Si pjesë e procesit të përcjelljes së vazhdueshme të efektit të dhënësit të shërbimeve publike, më së voni deri më 30 qershor të vitit, zbatohet intervistë gjysmëvjetore.

Pas zbatimit të intervistës gjysmëvjetore plotësohet raporti për intervistë gjysmëvjetore, të cilin e nënshkruajnë dhënësi i shërbimeve publike dhe eprori i drejtpërdrejtë i tij.

Kopja e raportit nga paragrafi 3 i këtij neni i parashtrohet dhënësit të shërbimeve publike.

Nëse në raportin për intervistën e gjysmëvjetorit, eprori i drejtpërdrejtë konstaton se dhënësi i shërbimeve publike nuk i ka plotësuar qëllimet e vendosura përkatësisht tregon rezultate të pamjaftueshme gjatë periudhës gjysmëvjetore, nuk tregon profesionalizëm dhe kompetencë të duhur, ka gabime serioze në punë dhe veprim, detyrat e punës nuk i kryen me kohë përkatësisht nuk tregon interes për cilësinë e kryerjes së detyrave të punës, i njëjti do të nisë procedurë për përmirësim të efektit.

Në procedurën për përmirësim të efektit propozohen trajnime shtesë ose mentori dhe shqiptohet paraljmërim me shkrim në të cilin dhënësi i shërbimeve publike paralajmërohet për mundësinë të vlerësohet me notë negative, nëse edhe krahas sugjerimeve dhe masave të propozuara, deri në kalimin e vitit për të cilin bëhet vlerësimi, nuk e përmirëson efektin e vet.

Neni 87 - i

Dhënësit e shërbimeve publike, në mënyrë të obligueshme notohen një herë në vit, edhe atë më së voni deri më 1 dhjetor të vitit rrjedhës.

Vlerësimin e dhënësit të shërbimeve publike e kryen eprori i drejtpërdrejtë (në tekstin e mëtejshëm: vlerësuesi).

Vlerësuesi me notë “1”, “2”, “3”, “4” ose “5” e vlerëson punën e dhënësit të shërbimeve publike në lidhje me kualitetin, efektivitetin dhe efikasitetin e punës, respektimin e afateve dhe nivelin e plotësimit të qëllimit të punëve dhe detyrave të përcaktuara, nivelin e përfshirjes dhe përkushtimit në punë, kontributin në realizimin e programit për punë në institucion, realizimin e planit individual për përsosje profesionale dhe sjelljen e dhënësit të shërbimeve publike, ndërsa e merr parasysht edhe raportin e intervistës gjysmëvjetore.

Nota vjetore e dhënësit të shërbimeve publike fitohet në bazë të notës së vlerësuesit që meret pjesë me 60%, si dhe nga nota mesatare nga dy dhënës të tjerë të shërbimeve publike në Agjenci me të cilin vlerësuesi ka pasur bashkëpunim të drejtpërdrejtë (në tekstin e mëtejshëm: vlerësuesit tjerë), e cila merr pjesë me 40%.

Vlerësuesit tjerë i zgjedh dhënësi i shërbimeve publike në marrëveshje me vlerësuesin e tij dhe të njëjtat me nota “1”, “2”, “3”, “4” ose “5” i vlerësojnë kompetencat e përgjithshme të punës të dhënësit të shërbimeve publike dhe propozojnë mënyrë të përmirësimit të punës të dhënësit të shërbimeve publike.

Për zbatimin e vlerësimit nga ana e vlerësuesve tjerë, drejtori i Agjencisë, më së voni deri më 1 tetor është i obliguar të miratojë aktvendim në të cilin do ta caktojë kohën dhe vendin e zbatimit të vlerësimit dhe do të formojë komision për zbatimin e vlerësimit.

Vlerësuesit nga paragrafi 5 të këtij neni janë të obliguar që në formular të përcaktuar t'i vlerësojnë dhënësit e shërbimeve publike dhe t'i dorëzojnë formularët për vlerësim te Komisioni në kohën dhe vendin e përcaktuar për zbatim të vlerësimit.

Formën dhe përmbajtjen e formularit nga paragrafi 7 të këtij neni i përcakton ministri kompetent për punët nga sfera e punës.

Pas përfundimit të vlerësimit, kopje nga formulari për vlerësim dorëzohet edhe te dhënësi i shërbimeve publike.

Nota vjetore e dhënësit të shërbimeve publike mund të jetë:

- „veçanërisht dallohet”, nëse ka vlerë prej 4,51 deri 5,00,
- „dallohet”, nëse ka vlerë prej 3,51 deri 4,50,
- „mjaftueshëm”, nëse ka vlerë prej 2,51 deri 3,50,
- „pjesërisht mjaftueshëm”, nëse ka vlerë prej 1,51 deri në 2,50 dhe
- „pamjaftueshëm”, nëse ka vlerë prej 1,00 deri në 1,50.

Kundër notës të efektit, dhënësi i pakënaqur i shërbimit publik ka të drejtë të parashtojë ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë, në afat prej tetë ditësh pas pranimit të kopjes së formularit për vlerësim.

Neni 87-j

Dhënës i shërbimeve publike i cili gjatë vitit për të cilin bëhet vlerësimi, ka munguar nga puna më gjatë se gjashtë muaj (pushim mjekësor, mungesë të papaguar dhe tjetër), si dhe dhënës i shërbimeve publike i cili për herë të parë është punësuar në Agjenci dhe ka punuar më shkurtë se gjashtë muaj në periudhën për të cilin bëhet vlerësimi, nuk do të jetë i vlerësuar.

Vlerësimin e dhënësit të shërbimeve publike, i cili gjatë vitit për të cilin bëhet vlerësimi, nëpërmjet procedurës së mobilitetit është sistemuar, përkatësisht marrë në vend tjetër të punës, e kryen vlerësuesi i ri, në bazë të raportit me shkrim nga vlerësuesi paraprak.

Nëse vlerësuesi gjatë vitit për të cilin bëhet vlerësimi, e ndërron vendin e punës ose i pushon marrëdhënie e punës, vlerësimin e dhënësit të shërbimeve publike me të cilat ka udhëhequr, e kryen vlerësuesi i ri, në bazë të raportit me shkrim nga vlerësuesi paraprak.

Përgjegjësia disiplinore e të punësuarve

Neni 87 - k

Të punësuarit në Agjenci që janë dhënës të shërbimeve publike, personalisht janë përgjegjës për ushtrimin e punëve dhe detyrave të punës nga vendi i punës.

Për cenim të detyrës zyrtare, dhënësi i shërbimeve publike nga paragrafi 1 i këtij neni përgjigjet në mënyrë disiplinore, për parregullsi disiplinore dhe shkelje disiplinore.

Parregullsia disiplinore paraqet cenim më të lehtë të disiplinës së punës, detyrave të punës dhe autoritetit të Agjencisë, si vijon:

- mosrespektim të kohës së punës, orarit dhe shfrytëzimit të kohës së punës,
- ruajtje të parregullt të shkresave dhe të dhënave zyrtare,
- mosardhje në punë dy ditë pune gjatë një viti kalendarik pa arsyetim,
- moskryerje, kryerje të papërgjegjshme ose të pakujdesshme të punës dhe detyrave të punës, me pasoja më të lehta nga cenimi,
- sjellje e pahijshme e dhënësit të shërbimeve publike gjatë ushtrimit të punës dhe detyrave të punës me pasoja më të lehta nga cenimi,
- shfrytëzim dhe përdorim joekonomik i mjeteve të besuara financiare dhe mjeteve për punë,
- mosnjohim i paarsyeshëm i eprorit të drejtpërdrejtë, përkatësisht i drejtorit për pengesën për mosardhje në punë në afat prej tri orësh dhe
- refuzim i aftësisë dhe përsosjes profesionale në të cilën dhënësi i shërbimit publik dërgohet.

Neni 87-II

Shkelje disiplinore paraqet cenimi më i rëndë i detyrës zyrtare, disiplinës së punës, autoritetit të Agjencisë ose autoritetit të dhënësit të shërbimeve publike, si vijon:

- moskryerje, kryerje të papërgjegjshme ose të pakujdesshme të punës dhe detyrave të punës me pasoja më të rënda nga cenimi,
- sjellje e pahijshme e dhënësit të shërbimeve publike gjatë ushtrimit të punës dhe detyrave të punës me pasoja më të rënda nga cenimi,
- shprehja dhe përfaqësimi i bindjes politike në ushtrimin e detyrave të punës, pjesëmarrje në aktivitete zgjedhore ose pjesëmarrje tjera publike me karakter të tillë gjatë kohës së punës, sjellja në pikëpyetje të statusit të vet të të punësuarit në Agjenci si dhënësi i shërbimeve publike me ushtrimin e aktiviteteve partiake, mbajtja ose paraqitja e simboleve partiake në hapësirën e punës,
- refuzim i dhënies ose dhënia e të dhënave të pasakta institucioneve, përkatësisht qytetarëve dhe personave juridikë, nëse dhënia e të dhënave është përcaktuar me ligj,
- disponim jologjor me mjete materiale dhe financiare,
- refuzim i ushtrimit të detyrave të punës të lidhura me vendin e punës në të cilin është sistemuar,
- refuzimi i urdhrit me shkrim për kryerje të detyrave të punës të lidhura me punën e Agjencisë të lëshuara nga eprori i drejtpërdrejtë përkatësisht drejtori,
- mosndërmarrja ose ndërmarrja jo e plotë e masave të përcaktuara për garantim të sigurisë së lëndëve të besuara në punë,
- shkaktimi i dëmit material me qëllim ose pakujdesi të skajshme,
- përsëritje të parregullsisë disiplinore më shumë se dy herë gjatë vitit rrjedhës,
- pranim i dhuratave ose lloji tjetër të dobisë,
- keqpërdorim i pushimit mjekësor,
- keqpërdorim i të dhënave të besueshme,
- keqpërdorim i të dhënave personale,
- keqpërdorim i autorizimeve të besuara në ushtrimin e detyrave të punës,
- futja dhe përdorimi, si dhe puna nën ndikim të alkooli ose mjeteve narkotike,
- mospërmbytje ndaj rregullave për mbrojtje nga sëmundja, siguri dhe shëndet gjatë punës, zjarri, eksplozimi, ndikimi i dëmshëm i helmeve dhe materieve tjera të rrezikshme dhe në rregullave për mbrojtje të mjedisit jetësor,
- vendosja e interesit personal financiar në konflikt me pozitën dhe statusin e dhënësi të shërbimeve publike,
- sjellje ofenduese ose e dhunshme në vendin e punës,
- dhënie të informatës së klasifikuar me shkallë sekreti, e përcaktuar me ligj dhe
- mosveprim sipas detyrimit për vlerësim të dhënësit të shërbimeve publike.

Përgjegjësia për vepër të kryer penale, përkatësisht kundërvajtje nuk e përjashton përgjegjësinë disiplinore të dhënësit të shërbimeve publike.

Neni 87-l

Me vendim për parregullsi të përcaktuar disiplinore të dhënësit të shërbimeve publike mund të shqiptohet njëra nga këto masa disiplinore:

- vërejtje me shkrim dhe
- dënim në para në lartësi prej 20% nga lartësia e shumës njëmuajore të rrogës neto të dhënësit të shërbimeve publike, e paguar në muajin e fundit para parregullsisë disiplinore në kohëzgjatje prej një deri në tre muaj.

Me vendim për shkelje të përcaktuar disiplinore, dhënësit të shërbimeve publike mund t'i shqiptohet njëra nga këto masa disiplinore:

- dënim në para në lartësi prej 30% nga lartësia e shumës njëmuajore të rrogës neto të dhënësit të shërbimeve publike, e paguar në muajin e fundit para shkeljes disiplinore, në kohëzgjatje prej një deri në gjashtë muaj dhe
- pushim i marrëdhënies së punës kur janë krijuar pasoja të dëmshme për Agjencinë, me ç'rast nuk janë përcaktuar rrethana lehtësuese për dhënësin e shërbimeve publike i cili e ka kryer shkeljen.

Shuma e dënimeve në para të shqiptuara dhënësit të shërbimeve publike në një muaj për parregullsi disiplinore dhe shkelje disiplinore nuk mund të tejkalojë 30% nga shuma e neto rrogës së tij të përgjithshme neto për atë muaj.

Neni 87-m

Çdo i punësuar në Agjenci dhe person tjetër, në pajtim me ligjin ka të drejtë të parashtrijë iniciativë për ngritje të procedurë disiplinore kundër dhënësit të shërbimeve publike në Agjenci, e cila duhet të jetë e arsyetuar.

Propozim për ngritje të procedurës disiplinore kundër dhënësit të shërbimeve publike parashtron eprori i drejtpërdrejtë.

Propozimi për ngritje të procedure për përcaktim të përgjegjësie disiplinore sipas rregullës i përmban këto elemente:

- emrin personal të dhënësit të shërbimeve publike për të cilin parashtrihet propozimi për ngritje të procedurës për përcaktim të përgjegjësive disiplinore,
- vendin e punës në të cilin është sistemuar dhënësi i shërbimeve publike për të cilin parashtrihet propozimi,
- përshkrimin e veprimit/ve me të cilin/at është kryer shkelja e rendit dhe disiplinës së punës ose mosplotësimi i detyrave të punës,
- kohën, mënyrën dhe vendin e kryerjes së veprimit me të cilin është kryer shkelja e rendit dhe disiplinës së punës ose mosplotësimi të detyrave të punës dhe
- theksimin e dëshmi/ve prej të cilave vërtetohet sjellja e këtillë, përkatësisht dëshmi që është në interes të faktit se është kryer veprimi (shënim zyrtar, raport me shkrim, informatë, fletëparaqitje, deklaratë dhe dëshmitarë).

Neni 87-n

Drejtori i Agjencisë formon Komisioni për mbajtje të procedurës disiplinore për shkelje disiplinore, në afat prej tetë ditësh nga dita e parashtrimit të propozimit për ngritje të procedurës disiplinore.

Komisioni nga paragrafi 1 i këtij neni është i përbërë prej tre anëtarëve dhe zëvendësues të tyre të punësuar në Agjenci të cilët nuk mund të jenë në titull më të ulët nga dhënësi i shërbimeve publike kundër të cilit mbahet procedura disiplinore.

Nëse Komisioni nga paragrafi 1 i këtij neni konstaton se dhënësi i shërbimeve publike nuk është përgjegjës, i propozon drejtorit ta refuzojë propozimin, përkatësisht ta ndërpresë procedurën.

Nëse Komisioni nga paragrafi 1 i këtij neni konstaton se dhënësi i shërbimeve publike është përgjegjës, i propozon drejtorit shqiptim të mase disiplinore për shkelje disiplinore.

Drejtori i Agjencisë, në bazë të propozimit të Komisionit nga paragrafi 1 i këtij neni, në afat prej pesë ditësh miraton aktvendim për shqiptim të masës disiplinore për shkelje disiplinore.

Neni 87-nj

Masë disiplinore për parregullsi disiplinore të dhënësit të shërbimeve publike shqipton drejtori i Agjencisë, në afat prej tetë ditësh nga dita e raportit të marrë me shkrim nga eprori i drejtpërdrejtë.

Para shqiptimit të masës disiplinore dhënësi i shërbimeve publike njoftohet me shkrim për konstatimet e raportit nga paragrafi 1 i këtij neni që ekzistojnë kundër tij dhe i njëjti ka të drejtë të japë përgjigje me shkrim në raportin nga paragrafi 1 i këtij neni, në afat prej tri ditësh.

Kundër vendimit për shqiptim të masës disiplinore dhënësi i pakënaqur i shërbimeve publike ka të drejtë që në afat prej tetë ditësh të parashtojë ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

Përgjegjësia materiale e dhënësve të shërbimeve publike

Neni 87-o

Dhënësi i shërbimeve publike në Agjenci është përgjegjës për dëmin të cilin në punë ose në lidhje me punën, me qëllim ose nga pakujdesia e skajshme, ia ka shkaktuar Agjencisë.

Drejtori i Agjencisë formon Komision për përcaktim të përgjegjësisë materiale të dhënësit të shërbimeve publike.

Komisioni nga paragrafi 1 i këtij neni është i përberë prej tre anëtarëve dhe zëvendësve të tyre të punësuar në Agjenci të cilët nuk mund të jenë në titull më të ulët nga dhënësi i shërbimeve publike kundër të cilit mbahet procedurë disiplinore.

Komisionin nga paragrafi 2 i këtij neni e përcakton përgjegjësinë materiale për ekzistim të dëmit të bërë material, lartësinë e tij dhe mënyrën e krijimit, kush e ka shkaktuar dëmin dhe kush do ta kompensojë.

Komisioni nga paragrafi 2 i këtij neni për gjendjen e përcaktuar faktike parashtron raport, në bazë të të cilit drejtori i Agjencisë miraton aktvendim për kompensim të dëmit.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 5 i këtij neni, dhënësi i shërbimeve publike në Agjenci ka të drejtë të deklarojë ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë, në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të së njëjtës.

Procedura për përcaktimin e përgjegjësisë materiale nuk mund të ngrihet nëse nga dita kur është kryer dëmi material ka kaluar një vit.

Pushimi i marrëdhënies së punës

Neni 87-p

Dhënësit të shërbimeve publike i pushon marrëdhënia e punës:

- me kërkesë të tij
- me marrëveshje,
- me forcë të ligjit dhe
- në raste tjera të përcaktuara me këtë dhe ligj tjetër dhe marrëveshje kolektive.

Dhënësit të shërbimeve publike i pushon marrëdhënia e punës në Agjenci nëse parashtron kërkesë me shkrim për pushim të marrëdhënies së punës.

Në rast të pushimi të marrëdhënies së punës me kërkesë të dhënësit të shërbimeve publike, afati i largimit zgjat 30 ditë nga dita e parashtrimit të kërkesës.

Dhënësit të shërbimeve i pushon marrëdhënia e punës me forcë të ligjit nëse:

- e humb aftësinë e punës me ditën e dorëzimit të aktvendimit të plotfuqishëm për përcaktim të aftësisë së humbur të punës,

- i pushon shtetësia e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me ditën e dorëzimit të aktvendimit për heqje nga shtetësia e Republikës së Maqedonisë së Veriut,

- dënohet për vepër penale në lidhje me detyrën zyrtare me ditën e plotfuqishmërisë së aktgjykimit,

- i është shqiptuar ndalim për ushtrim të profesioni, veprimtarisë ose detyrës, me ditën e plotfuqishmërisë së aktgjykimit,

- për shkak të vuajtjes së dënimit me burg në kohëzgjatje më të gjatë se gjashtë muaj, me ditën e fillimit të vuajtjes së dënimit,

- mungon pa arsye nga puna së paku tri ditë të njëpasnjëshme pune në një muaj,

- konstatohet se gjatë punësimit ka heshtur ose ka dhënë të dhëna të pavërteta në lidhje me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për punësim,

- në afat prej tri ditësh nuk kthehet në punës pa përfundimit të mungesës së papaguar,

- organi i administratës shtetërore kompetent për mbikëqyrje inspektuese në afat prej një viti konstaton se dhënësi i shërbimeve publike është punësuar në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe kushtet të tjera në pajtim me ligjin.

Dhënësit të shërbimeve publike i pushon marrëdhënia e punës nëse vlerësohet me notë "pamjaftueshëm" dy herë në mënyrë të njëpasnjëshme ose së paku tri herë në pesë vitet e fundit.

Neni 87-r

Aktvendimin për pushim të marrëdhënies së punës të dhënësit të shërbimeve publike e miraton drejtori.

Aktvendimi për pushimin e marrëdhënies së punës i dorëzohet personalisht dhënësit të shërbimeve publike në hapësirat e punës të Agjencisë, përkatësisht në adresë të vendbanimit të tij.

Nëse dhënësi i shërbimeve publike nuk mund të gjendet në adresën e vendbanimit ose nëse e refuzon dorëzimin, aktvendimi shpallet në tabelën e shpalljeve të Agjencisë dhe pas kalimit të tetë ditëve konsiderohet se aktvendimi është dorëzuar.

Kundër aktvendimit dhënësi shërbimeve publike ka të drejtë që në afat prej tetë ditësh të parashtrorë ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

Persona ndihmës-teknikë

Neni 87-s

Të punësuarit në Agjenci, që kryejnë punë ndihmëse-teknike, kanë status të personave ndihmës-teknikë nga Grupi IV dhe për ta përcaktohen këto nëngrupe, kategori dhe nivele:

- nëngrupi 1 kategoria A,

- nëngrupi 2 kategoria A,

- nëngrupi 3 kategoria A,

- nëngrupi 4 kategoria A,

- nëngrupi 5 kategoria A.

Për çdo kategori në nëngrupet 1, 2, 3, 4 dhe 5 përcaktohen tre nivele, si vijon:

A01 -persona ndihmës-teknikë të nivelit të parë, me së paku nivel të kualifikimit IV, 240 kredi sipas ECVET ose SMKAP ose arsim të mesëm katërvjeçar,

A02- persona ndihmë-teknikë të nivelit të dytë, me nivel më të vogël të kualifikimeve III, 180 kredi sipas ECVET ose arsim të mesëm trevjeçar dhe

A03 - persona ndihmës-teknikë të nivelit të tretë me së paku nivel të kualifikimeve I ose arsim fillor.

Për çështje të cilat kanë të bëjnë me kualifikimin, evidencën, punësimin, avancimin, përsosjen dhe aftësimin profesional dhe çështje tjera në lidhje me marrëdhënien e punës të personave ndihmës-teknikë të punësuar në Agjenci, zbatohen dispozitat e këtij ligji, Ligjit për të punësuarit në sektorin publik dhe rregullat e përgjithshme nga sfera e marrëdhënieve të punës.

Klasifikimi i llojeve të vendeve të punës nga paragrafi 1 i këtij neni, kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për çdo vend pune, do të përcaktohen me aktin për organizim të brendshëm dhe aktin për sistematizim të vendeve të punës në Agjenci.

Rroga dhe kompensime të rrogës për dhënësit e shërbimeve publike dhe personat-ndihmës teknikë

Neni 87-t

Dhënësit e shërbimeve publike dhe personat ndihmës-teknikë në Agjenci kanë të drejtë rroge dhe kompensime të rrogës me kushte dhe kritere të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 87-q

Rroga e dhënësve të shërbimeve publike dhe personave ndihmës-teknikë përbëhet nga këta komponentë:

- komponenti bazë dhe
- komponenti i jashtëzakonshëm.

Komponentin themelor të rrogës e përbëjnë:

- pjesa e rrogës për shkallën e arsimit,
- pjesa e rrogës për nivel,
- pjesa e rroge për stazh pune.

Pjesa e rrogës për shkallën e arsimit e cila kërkohet si minimum për vendin e punës vlerësohet në këtë mënyrë:

NIVELI I KUALIFIKIMEVE/ARSIMI	PIKË
Niveli i kualifikimeve VI A, 240 kredi sipas SETK ose shkallën VII/1 të përfunduar	200
Niveli i kualifikimeve VI B, ose 180 kredi sipas SETK	175
Niveli i kualifikimeve V A, 60 deri në 120 kredi sipas SETK ose arsim të lartë	150
Niveli i kualifikimeve IV, 240 kredi sipas ECVET ose SMKAP ose arsim të mesëm katërvjeçar	100
Niveli i kualifikimeve III, 180 kredi sipas ECVET ose SMKAP ose arsim të mesëm profesional trevjeçar	90
Niveli i kualifikimeve II, 60 deri në 120 kredi sipas ECVET ose SMKAP ose aftësim profesional në kohëzgjatje deri në dy vjet	80
Niveli i kualifikimeve I, arsim fillor të përfunduar	70

Pjesa e rrogës për nivelin në të cilin i punësuar i është i sistemuar vlerësohet në këtë mënyrë:

NIVELI	PIKË
DHËNËS TË SHËRBIMEVE PUBLIKE	
Kategoria A	
A1 - koordinator i seksionit	346
A2 - nëpunës i lartë profesional për përgatitje për punësim	281
A3 - nëpunës i pavarur profesional për përgatitje për punësim	246
A4 - nëpunës profesional për përgatitje për punësim	231
A5 - nëpunës i ri për përgatitje për punësim	201
Kategoria B	
B1 - koordinator i seksionit	346
B2 - nëpunës i lartë profesional për ndërmjetësim gjatë punësimit	281
B3 - nëpunës i pavarur profesional për ndërmjetësim gjatë punësimit	246
B4 - nëpunës profesional për ndërmjetësim gjatë punësimit	231
B5 - nëpunës i ri profesional për ndërmjetësim gjatë punësimit	201
PERSONA NDIHMËS - TEKNIKË	
kategoria A niveli A1	196
kategoria A niveli A2	181
kategoria A niveli A3	166

Pjesa e rrogës për stazhin e punës të dhënësve të shërbimeve publike dhe personave ndihmës - teknikë vlerësohet në shumë prej 0,5% nga pjesët e rrogës për shkallë të arsimit dhe për nivel, për çdo vit të përfunduar të stazhit të punës, e më së shumti deri në 20%.

Neni 87-u

Vlera e pikës për llogaritjen e rrogave të të punësuarve në Agjenci përcaktohet çdo vit me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut e cila me propozim të drejtorit të Agjencisë miratohet në afat prej dhjetë ditësh nga dita e miratimit të buxhetit të Agjencisë, e në kuadër të buxhetit të paraparë dhe në bazë të numrit të përgjithshëm të të punësuarve në Agjenci, të sistemuar sipas niveleve adekuate për vitin rrjedhës.

Neni 87-f

Komponentin e jashtëzakonshëm e përbëjnë: shtesa e rrogës për punë nate, punë në ndërrime dhe punë jashtë orarit.

Dhënësit e shërbimeve publike dhe personat ndihmës-teknikë në Agjenci kanë të drejtë shtese të rrogës për:

- punë nate,
- punë në ndërrime,
- punë gjatë kohës së pushimit javor,
- punës për kohë të festave të përcaktuara me ligj dhe
- punë më të gjatë se koha e plotë e punës.

Vendet e punës nga paragrafi 1 alinetë 1 dhe 2 të këtij neni, duhet të jenë të parapara në aktin për sistematizim të vendeve të punës.

Shtesa e rrogës për punë nate për orë vlerësohet në shumë prej 35% nga shuma e rrogës bazë për orë.

Shtesa e rrogës për punë në ndërrime për orë vlerësohet në shumë prej 5% nga shuma e rrogës bazë, e llogaritur për orë.

Dhënësi i shërbimeve publike dhe personi ndihmës-teknik i cili ka qenë i angazhuar të punojë në pajtim me kushtet nga paragrafi 1 alinetë 3, 4 dhe 5 të këtij neni, ka të drejtë në aq orë të lira, përkatësisht ditë, sa ka qenë i angazhuar për punë jashtë kohës së rregullt të punës.

Orët e lira, përkatësisht ditët, nga muaji rrjedhës, dhënësi i shërbimeve publike përkatësisht personi ndihmës - teknik i shfrytëzon deri në fund të muajit të ardhshëm, pas muajit në të cilin ka qenë i angazhuar.

Nëse dhënësit të shërbimeve publike përkatësisht personave ndihmës - teknikë nuk u sigurohet shfrytëzimi i orëve të lira, përkatësisht ditëve në pajtim me paragrafin 6 të këtij neni, i paguhet shtesë e rrogës në shumë prej 35% nga shuma e rrogës bazë, e llogaritur për orë.

Shtesat e rrogës nga paragrafi 1 i këtij neni, ndërmjet veti nuk përjashtohen.

Evidentimi i orëve të punës të kaluara në punë me kushte të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, kryhet në pajtim me ligjin."

Neni 19

Në nenin 88 në paragrafin 2 fjalët: "dhe në aktet për organizim dhe sistematizim" shlyhen.

Pas paragrafit 2 shtohet paragraf i ri 3, si vijon:

"Pëlqim për aktet për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës të Agjencisë jep Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës. "

Neni 20

Pas nenit 91 shtohet nen i ri 91-a, si vijon:

"Neni 91-a

Pas emërimit të drejtorit, përkatësisht zëvendësdrejtorit të Agjencisë, lidhet kontratë menaxheriale ndërmjet drejtorit të emëruar, përkatësisht zëvendësdrejtorit dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut."

Neni 21

Në nenin 98 në paragrafët 1 dhe 3 fjalët: "tatimi personal mbi të ardhura" zëvendësohen me fjalët: "tatimi mbi të ardhura personale".

Neni 22

Në nenin 98-g paragrafi 1 në fjalinë hyrëse dhe në alinetë 1 dhe 2, neni 98-d në paragrafët 1, 2, 3 dhe 5, në nenin 98-e në paragrafët 3, 4, 5, 6 dhe 7 dhe në nenin 98-zh në paragrafin 4 fjalët: "tatim personal mbi të ardhura " zëvendësohen me fjalët "tatim mbi të ardhura personale".

Neni 23

Në nenin 100 paragrafi 3 shlyhet.

Neni 24

Statuti dhe aktet për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës në Agjenci do të harmonizohen me dispozitat e këtij ligji në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 25

Akti nënligjor i paraparë me këtë ligj, do të miratohet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 26

Procedurat e filluara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të përfundohen në pajtim me Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 37/97, 25/00, 101/00, 50/01, 25/03, 37/04, 4/05, 50/06, 29/07, 102/08, 161/08, 50/10, 88/10, 51/11, 11/12, 80/12, 114/12, 39/14, 44/14, 113/14, 56/15, 129/15, 147/15, 154/15, 27/16, 119/16, 21/18 dhe 113/18).

Neni 27

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".